



Republika e Kosovës

Ministria e Infrastrukturës dhe Mjedisit

Gjelbërimi i tokës – Korniza e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS) Përmbledhje Ekzekutive

Në Kosovë sa i përket vendeve të kontaminuara situata karakterizohet të jetë relativisht e pakontrolluar me një inventarizim fillestar të lokacioneve që konsiderohen veçanërisht të kontaminuara (hotspotet) të kryer në vitin 2011 nga Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, dhe publikimin e Udhëzimit Administrativ Nr.11 / 2018 për Vlerat kufitare të emisioneve të materieve ndotëse në toke, prandaj Kosova është në gjendje të ndjekë një qasje ndërkombëtare - menaxhim të qëndrueshëm të tokës bazuar në rrezik (Sustainable Risk Based Land Management - SRBLM) për menaxhimin e tokës së kontaminuar dhe prioritizimin e veprimeve sipas fazave.

Projekti i propozuar i Bankës Botërore Gjelbërimi i tokës (Greening Land) synon të mbështesë vendin në zhvillimin dhe zbatimin e një plani të veprimit afatgjatë për riparinin dhe ri-zhvillimin e tokave të kontaminuara në Kosovë. Projekti do të kontribuojë në zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve ekzistuese për mbrojtjen e mjedisit, në zbutjen dhe përshtatjen e efekteve nga ndryshimeve klimatike duke adresuar pengesat e identifikuar. Do të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të tokës së kontaminuar për të zvogëluar rreziqet e shoqëruara shëndetësore dhe për të realizuar vlerat ekonomike, mjedisore dhe sociale nga ri-zhvillimi i tokës, siç është krijimi i hapësirave të gjelbëruara urbane, zhvillimi komercial, dhe prodhimi i energjisë së ripërtëritshme.

Projekti do t'i ofrojë qeverisë mbështetje në adresimin e pengesave kryesore me të cilat është përballur ndër vite në administrimin e tokës së kontaminuar. Këtë do ta bëjë këtë përmes:

- a) investimeve në lokacionet e përzgjedhura për të demonstruar praktika të mira ndërkombëtare për riparinin dhe ri-zhvillimin e tokave të ndotura, dhe
- b) mundësimin e aktiviteteve në nivelin kombëtar dhe lokal për zhvillimin e kornizave politike / rregullative dhe institucionale të domosdoshme, ngritjen e kapaciteteve, adresimin e boshllëqeve të të dhënave / informacioneve dhe zhvillimin e një plani të veprimit afatgjatë për riparinin dhe ri-zhvillimin e tokave të kontaminuara në vend.

SRBLM do të jetë qasja kryesore që do të promovohet përmes projektit të propozuar. Projekti do të kontribuojë në përkushtimin e Kosovës në procesin e anëtarësimit në BE dhe përafrimit të rregullativës së mjedisit dhe ndryshimeve klimatike me legjislacionin e BE-së. Pritet që projekti të jetë pika fillestare e një programi afatgjatë për adresimin e ndotjes së trashëguar të tokës në Kosovë. Fazat e mëvonshme për përshkallëzimin parashikohen ose si financim shtesë ose si një projekt i ri që do të financohet nga Banka ose / dhe partnerët e tjerë.

Projekti i propozuar përbëhet nga tre komponentë të përshkruara më poshtë:

- **Komponenti 1: Demonstrimi i riparitimit dhe ri-zhvillimit të qëndrueshëm të tokave të kontaminuara bazuar në rrezik (rreth US\$ 17.1 milion)**
 - Nën-komponenti 1.1 Riparimi dhe ri-zhvillimi në lokacionin e Korporatës Energjetike të Kosovës, i vendosur në një zonë më të madhe të Prishtinës (rreth US\$ 5 milion)
 - Nën-komponenti 1.2 Përgatitja e planeve për riparim dhe ri-zhvillim në dy ose tre lokacione të tjera (rreth US\$ 1.1 milion)
 - Nën-komponenti 1.3 Riparimi dhe ri-zhvillimi në një ose dy lokacione tjera (rreth US\$ 11 milion)

- **Komponenti 2: Zhvillimi i politikave dhe kapaciteteve institucionale për menaxhimin e tokave të ndotura (rreth US\$ 3.1 milion)**
 - Nën-komponenti 2.1 Identifikimi në nivel kombëtar i lokacioneve të dyshuara dhe një inventar i tokave të ndotura në një ose dy komuna të përzgjedhura.
 - Nën-komponenti 2.2 Ndërtimi i politikave dhe i kapaciteteve institucionale dhe ndërgjegjësimi.
 - Nën-komponenti 2.3 Opsionet e financimit të qëndrueshëm dhe Plani Kombëtar i Veprimit për SRBLM.
 - Nën-komponenti 2.4 Studimi mbi planifikimin e investimeve për menaxhimin e mbeturinave industriale (të rrezikshme dhe jo të rrezikshme)
- **Komponenti 3: Menaxhimi, monitorimi dhe vlerësimi i projektit (US \$ 0.8 milion)**

Qëllimet kryesore të KMMS janë të:

- përcaktohen kërkesat ligjore të përshkruara në Kornizën Mjedisore dhe Sociale të Bankës Botërore (KMS) dhe legjislacionin e Kosovës në mënyrë që aktivitetet e projektit do jenë në pajtueshmëri gjatë zbatimit të tyre;
- përcaktohen parimet e përgjithshme, rregullat, udhëzimet dhe procedurat për të vlerësuar rreziqet mjedisore dhe sociale dhe ndikimet që lidhen me lokacionin dhe aktivitetet për të cilat informacioni i detajuar nuk është i disponueshëm;
- përmbajnë masa dhe plane të përgjithshme për të zvogëluar, zbutur dhe / ose për të kompensuar rreziqet dhe ndikimet e pafavorshme, dhe informacione për agjencinë ose agjencitë përgjegjëse për adresimin e rreziqeve dhe ndikimeve të projektit, duke përfshirë aftësinë e tyre për të menaxhuar rreziqet dhe ndikimet mjedisore dhe sociale;
- sigurohet se të gjitha çështjet e rëndësishme mjedisore dhe sociale janë përfshirë në hartimin dhe zbatimin e nën-projekteve
- ofroj udhëzime për përgatitjen e dokumenteve të ndryshme të masave mbrojtëse
- ofroj udhëzime për të siguruar përfshirjen e palëve të interesuara gjatë fazave të ndryshme të zbatimit të nën-projekt-it/-eve.

Korniza e Menaxhimit Mjedisor dhe Social (KMMS) është strukturuar si më poshtë:

- Kapitulli 1 ofron një përmbledhje të shkurtër të sfondit të projektit, jep një përshkrim të objektivave dhe përbërësve të ndryshëm të projektit, fushëveprimit dhe qëllimit të KMMS, dhe përshkrim të qasjes dhe metodologjisë së projektit.
- Kapitulli 2 përshkruan politikat përkatëse, kornizën legjislative dhe rregullative për këtë projekt.
- Kapitulli 3 jep udhëzimin për mbledhjen e të dhënave bazë në zonat e ndikimit të projektit.
- Kapitulli 4 përshkruan rreziqet e mundshme / të pritshme mjedisore dhe sociale dhe ndikimet e projektit.
- Kapitulli 5 përshkruan masat tipike zbutëse për nën-projekte të ndryshme.
- Kapitulli 6 përshkruan aranzhimet institucionale dhe të monitorimit të projektit.
- Kapitulli 7 përfshin objektivin për konsultimin e palëve të interesit dhe shpalosjen publike, metodologjinë dhe mjetet për konsultimin e palëve të interesuara.

Objekti i propozuar zhvillimorë është të demonstrohet një qasje të qëndrueshme e bazuar në rrezik për riparimin dhe ri-zhvillimin e lokacioneve të kontaminuara.

Përzgjedhja e lokacion-it/-eve do të bëhet gjatë zbatimit të projektit në konsultim me qeverinë dhe do të ndjekë një sërë kriteresh, duke përfshirë:

- (i) kompleksitetin e ulët të veprimeve për përmirësimin e tokave të kontaminuara, në mënyrë që projekti të demonstrojë sukses;
- (ii) të ketë potencial të fuqishëm për përfshirjen e komunitetit, dhe potencial të lartë të integritetit të përmirësimeve me përfitimet ekonomike dhe beneficione shoqërore, si p.sh. regjenerimi me qëllim të rritjes së kënaqësisë publike, mbrojtja e resurseve ujore, zhvillimi i burimeve të ripërtëritshme të energjisë, rikuperimi i materialeve, promovimi i industrisë së gjelbërt, dhe ndërtimi i kapaciteteve njerëzore dhe demonstrimi i rezultateve gjatë kohëzgjatjes së projektit.
- (iii) mundësinë e kontributit financiar nga qeveria (niveli qendror ose lokal) ose sektori privat i lidhur me lokacionin.




Figura 1 Lokacioni i nën-projekteve indikative

Lista e shkurtër e nën-projekteve indikative demonstruese të grupuara nga përdorimi i mundshëm i tokës në të ardhmen ose opsionet e ri-zhvillimit nën Nën-Komponentin 1.2 janë si më poshtë:

a) Zhvillimi i parqeve dhe hapësirave publike:

- (i) Zona e ndikuar me asbest në Han të Elezit me qëllim të krijimit të një parku linear, që lidhet me një plan ekzistues zhvillimor të përgatitur tashmë nga komuna, e që gjithashtu mund të përfshin përmirësimet e një lokacioni ekzistues ku janë hedhur tokat e kontaminuara me asbest (me qëllim të përmbushjes të standardeve evropiane) dhe për të menaxhuar asbestin e hequr nga ndërtesat e vjetra dhe gjatë nxjerrjes së tokave të ndotura me asbest gjatë riparimit.
- (ii) Parku Industrial i Mitrovicës, krijimi i "Parkut të Paqes" nëpër komunitete të ndryshme të Mitrovicës. Krijimi i një Master Plani i cili integron riparimin dhe ri-zhvillimin me mbështetjen për mbledhjen e fondeve dhe krijimin e partneriteteve për rigjenerimin e "Parkut të Paqes", dhe të shërbejë si bazë teknike për pastrim efektiv në fazën tjetër të menaxhimit të tokës së kontaminuar.

b) Sigurimi i burimeve të ujit të pastër:

- (iii) Lokacioni i mbetjeve të flotacionit pranë minierës në Artanë – që ndotë ujin i cili përfundon në zonën e rezervuarit të ardhshëm të digës Kramenata që do të mbështetet nga projekti FLOWS i Bankës Botërore dhe promovimi i teknikave të qëndrueshme në miniera për të parandaluar ndotjen e mëtejshme.
- (iv) Pilotimi i industrisë së gjelbër të integruar dhe ripërpunimi i mbetjeve historike nga flotacionet si bazë për ri-përsëritjen në faza tjera nëpër lokacione dhe objekte të ndryshme të Trepçës.

c) Menaxhimi i integruar i mbeturinave komunale

- (v) Riparimi i deponisë sanitare regjionale në Mirash.

Zakonisht mendohet se riparimi i tokave të kontaminuara mund të rezultojë vetëm në përmirësimin e mjedisit. Sidoqoftë, ndërsa riparimi i tokës së ndotur dhe ujit kryhet me qëllim të përmirësimit të mjedisit, vetvetiu gjatë këtyre aktiviteteve përmirësuese ka mundësi të ketë veprime që ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut ose mjedisin. Rreziqet e mundshme duhet të kontrollohen, për të siguruar që riparimi

të rezultojë në një përmirësim mjedisor. Kjo normalisht arrihet përmes zbatimit të një skeme të rregulluar të rregullimit dhe zbatimit të kontrollit legjislativ, mbi dhe mbi atë që përcakton objektivat e riparimit. Kjo është arsyeja pse është e nevojshme të kryhet analizat e alternativave.

Analiza e alternativave të planit të riparimit dhe ri-zhvillimit për lokacionin e kontaminuar duhet të bëhet në nivel të strategjive të aplikuara të riparimit, në vend të zgjidhjeve teknologjike.

Bazuar në këtë, për listën e shkurtër indikative të nën-projekteve demonstruese, studimet e VNMS do të analizojnë alternativat në mënyrën e mëposhtme:

- Hapi 1: Përshkrimi i lokacionit
- Hapi 2: Përshkrimi i alternativave:
 - a. Alternative Zero ose 'mos bëjë asgjë',
 - b. Alternativa të ndryshme për riparimin dhe ri-zhvillimin e tokës së ndotur në lidhje me
 - i. aktivitetet e propozuara, dhe
 - ii. teknologjitë e propozuara
- Hapi 3: Vlerësimi i alternativave
- Hapi 4: Veprimet e rekomanduara

Studimet e propozuara në lidhje me këtë projekt dhe KMMS janë si më poshtë:

- Studimi i Fizibilitetit për Planin e Riparimit të lokacionit të kontaminuar, përfshirë këtu hulumtimin e detajuar të lokacionit, dhe dizajnin e detajuar për riparim dhe rehabilitim,
- Hartimi i projektit të detajuar të rehabilitimit,
- Vlerësimi i Ndikimit Mjedisor dhe Social (VNMS),
- Plani i Menaxhimit Mjedisor dhe Social (PMMS),
- Korniza e Politikave të Zhvendosjes (KPZh) dhe Plani i Veprimit për Zhvendosje (PVZh),
- Aktivitetet e Monitorimit (Implementimi PMMS).

Pritet që vlerësimet e hollësishme mjedisore dhe sociale për lokacionet e projektit ku do të zbatohen aktivitete specifike do të kryhen (në përputhje me këtë Kornizë) dhe do të rishikohen dhe vlerësohen nga Banka Botërore, MeIM ose komunat përkatëse, p.sh. Departamenti për Mbrojtje të Mjedisit, si dhe institucionet e tjera përkatëse.